

FOL



VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI PADITË STRATEGJIKE KUNDËR PJEËMARRJES PUBLIKE (PADITË SLAPP)

**VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI
PADITË STRATEGJIKE KUNDËR
PJESËMARRJES PUBLIKE
(PADITË SLAPP)**

Tetor, 2022

Titulli: Vështrim i përgjithshëm mbi Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike
(Paditë SLAPP)

Autor: Lëvizja FOL

Viti i botimit: Tetor 2022

Publikuar nga: Lëvizja FOL

Andrea Gropa nr.35

Prishtinë 10000, Republika e Kosovës

info@levizjafol.org

+386 (0)49 131 542

Ky botim është krijuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e organizatës Lëvizja FOL dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Projekti Anti-SLAPP mbështetet nga programi “Safejournalists.net”.



PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	4
2. METODOLOGJIA..	5
3. PADITË STRATEGJIKE KUNDËR PJESËMARRJES PUBLIKE (SLAPP).....	6
3.1 ÇKA JANË PADITË SLAPP?.....	6
3.2 CILAT JANË SUBJEKTET MË TË RREZIKUARA NGA KËTO PADI DHE NGA KUSH PARASHTROHEN?.....	7
3.3 A KA MEKANIZMA LIGJOR PËR MBROJTJE NDAJ KËTYRE PADIVE?.....	8
4.NIVELI I PËRHAPJES SË FENOMENIT “SLAPP”	10
4.1 PËRHAPJA E PADIVE SLAPP NË NIVEL NDËRKOMBËTAR.....	10
4.2 VEPRIMTARIA E KOALICIONIT KUNDËR PADIVE SLAPP NË EVROPË (COALITION AGAINST SLAPPs IN EUROPE - CASE).	12
4.3 PËRHAPJA E PADIVE SLAPP NË NIVEL KOMBËTAR.....	13
5. SA JANË TË NJOFTUAR GAZETARËT DHE AKTIVISTËT KOSOVARË ME PADITË SLAPP ?.....	16
6. REKOMANDIME.	18

1. HYRJE

Sulmet, kërcënimet dhe presionet ndaj gazetarëve dhe aktivistëve të tjerë të medias dhe të shoqërisë civile kohët e fundit kanë marrë përmasa të mëdha, duke u shndërruar kështu në shkelje serioze të të drejtave të njeriut. Këto sulme nuk synojnë vetëm këto kategori, por përfshijnë të gjithë qytetarët që tentojnë të shprehin publikisht opinionet dhe qëndrimet e tyre në temat me interes publik.

Padyshim se sigurimi i një ambienti të sigurt për gazetarët, aktivistët apo individët e tjerë është domosdoshmëri për një shoqëri demokratike. Kufizimi i lirisë së shprehjes nëpërmjet parashtrimit të padive SLAPP përveç që përbën rrezik për demokracinë, ajo paraqet shqetësim serioz për sigurinë juridike.

Dihet se gjykatat janë institucionet para të cilave duhet të drejtohen qytetarët me qëllim që të zgjidhin kontestet e tyre, në mënyrë që t'i mbrojnë të drejtat e tyre të cenuara. Mirëpo, ndonjëherë kjo "rrugë gjyqësore" keqpërdoret nga individë të caktuar për të mbrojtur interesat e tyre personale dhe për të arritur qëllime të paligjshme.

Shpeshherë fushatat e aktivistëve për mbrojtjen e çështjeve me interes publik, shkrimet investigative të gazetarëve mbi tema të ndryshme, si dhe aktiviteti i aktivistëve të shoqërisë civile, përbëjnë pengesë për individë apo kompani të caktuara. Këta të fundit përdorin mundësinë e padisë si mjet ligjor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, për të penguar dhe frikësuar aktivistët apo gazetarët në aktivitetin e tyre, në mënyrë që të mos shprehin publikisht opinionet e tyre.

Pra, paditë të cilat kanë për qëllim që të heshtin kundërshtarët me qëllim që të kufizojnë aftësinë e tyre për të marrë pjesë në sferën publike, njihen si Padi Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (Paditë SLAPP). Këto padi, ndonëse dihet se janë të pabaza nga vet paditësit, ato kanë për qëllim që të frikësojnë dhe heshtin kundërshtarët, duke i kërcënuar me harxhime të larta për mbrojtje ligjore para gjykatës. Prandaj, nevojitet përgjigje adekuate e shoqërisë dhe e institucioneve shtetërore ndaj padive SLAPP në mënyrë që të ndërtohen mekanizma parandalues për parashtruesit e këtyre padive.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në kuadër të Kapitullit të të drejtave dhe lirive themelore, e mbron dhe e garanton edhe lirinë e shprehjes. Me këtë garantohet posaçërisht e drejta e shprehjes, shpërndarjes dhe pranimit të informacioneve dhe mesazheve tjera pa asnjë pengesë. Kjo u mundëson gazetarëve që ta ushtrojnë profesionin e tyre lirshëm dhe pa u penguar nga askush, duke e informuar në vazhdimësi opinionin publik rreth çështjeve me rëndësi publike, siç janë: sistemi i drejtësisë, ekonomia, mjedisi, korrupsioni dhe llogaridhënia e zyrtarëve publik.

Pra, ashtu siç e thekson edhe Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën për vitin 2022[1], shqetësimet e lirisë së shprehjes në Kosovë mbeten në lidhje me fushatat e shpifjeve publike, kërcënimeve dhe gjuhën e urrejtjes në mediat sociale, disa prej të cilave drejtohen posaçërisht kundër gazetarëve. Raporti gjithashtu thekson se jo të gjitha kërcënimet ndaj gazetarëve dhe mediave raportohen tek autoritetet kompetente dhe se gjykimi i çështjeve ndaj kësaj kategorie mbetet i ende i ngadaltë.

1] COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT, Kosovo* 2022 Report, Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions.

2.METODOLOGJIA

Qëllimi i këtij raporti është informimi i qytetarëve mbi nocionin dhe nivelin e përhapjes së padive SLAPP kohëve të fundit në Kosovë, se cilat janë subjektet më të rrezikuara, nga kush zakonisht parashtrohen dhe se cilët janë mekanizmat ligjor për mbrojtjen nga këto padi.

Raporti gjithashtu përshkruan edhe disa nga rastet e padive SLAPP më të njohura ndërkombëtare, të cilat kanë pasur ndikim në zhvillimin e legjislacionit anti-SLAPP, si dhe përshkruan disa prej rasteve të padive SLAPP ndaj gazetarëve dhe aktivistëve kosovarë, duke kontribuar në dokumentimin e padive SLAPP, si dhe në ofrimin e ndihmës për të paditurit.

Hulumtimi është kryer përmes përdorimit të materialeve online, duke përfshirë mediat dhe artikujt e ndryshëm, paditë e parashtruara, raportet nga OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare, si dhe duke u bazuar në legjislacionin vendas.

Ndër të tjera, në raport janë përfshirë edhe anketat e bëra me 26 gazetarë dhe aktivistë të shoqërisë civile në lidhje me atë se sa janë të informuar me paditë SLAPP dhe me mekanizmat ligjorë për mbrojtjen e tyre dhe se a kanë qenë ndonjëherë të kërcënuar nga ngritja e këtyre padive, apo se a kanë pasur rast të përballen me to nëpër gjykata.

Në fund, raporti ofron disa rekomandime, adresimi i të cilave do të krijonte një mjedis më të favorshëm për gazetarët, hulumtuesit dhe aktivistët tjerë të shoqërisë civile, në mbrojtjen e interesit të përgjithshëm shoqëror.

3. PADITË STRATEGJIKE KUNDËR PJESËMARRJES PUBLIKE (SLAPP)

3.1 ÇKA JANË PADITË SLAPP?

Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike, apo të njohura ndryshe si Paditë SLAPP (Strategic Lawsuits Against Public Participation) janë padi që synojnë të censurojnë, frikësojnë dhe heshtin kritikët, duke i detyruar të ju nënshtrohen kushteve të parashtruara nga ta dhe kostove të larta të mbrojtjes ligjore, e njëkohësisht t'i detyrojnë t'i tërheqin kritikata e tyre. Pra, këto padi synojnë të minojnë angazhimin aktiv publik, si dhe janë formë e hakmarrjes, që synojnë të cenojnë lirinë e shprehjes së aktivistëve dhe gazetarëve për çështjet me interes publik.

Termi "SLAPP" u krijua nga profesorët George W. Pring dhe Penelope Canan në librin e tyre "SLAPPs: Getting Sued for Speaking Out (1996)". Ky term në përgjithësi i referohet një padie të ngritur nga ndonjë subjekt i fuqishëm (p.sh. ndonjë korporatë, zyrtarë publik, person i profilit të lartë etj.) kundër individëve ose organizatave joqeveritare për shkak të shprehjes së ndonjë qëndrimi kritik për ndonjë çështje me interes politik apo shoqëror [2].

Paditë SLAPP rrezikojnë të cenojnë rëndë lirinë e shprehjes së atyre që deklarohen publikisht, duke i frikësuar dhe kërcënuar ata se nëse vijnë të veprojnë ashtu, në të ardhmen do të përballën me padi e kërcënime të tilla. Ndonëse janë të pabazuara në fakte dhe se qartësisht nuk do të rezultojnë të jenë të suksesshme në gjykatë, këto padi synojnë të shtypin të paditurit për opinionet dhe informacionet me interes publik të shprehura publikisht, opinione që nuk kanë të bëjnë fare me shpifje.

Çështjet që atakohen më shumë nga paditë SLAPP janë çështjet që kanë të bëjnë me interesin publik, si p.sh. mjedisi, korrupsioni, apo veprimet tjera të paligjshme që janë me interes publik dhe që kanë efekt në ekonominë kombëtare dhe në buxhetin e vendit.

Sipas profesorit George W. Pring, puna e të cilit fillimisht identifikoi dhe kategorizoi paditë SLAPP, ekzistojnë katër kritere të cilat i përmbajnë këto padi:

- paraqesin ndonjë ankesë civile ose kundërpadi që kërkon kompensim monetar dhe/ose urdhër ndalimi;
- janë ngritur kundër një grupi apo individi joqeveritar;
- janë ngritur për shkak të ndonjë çështje me interes publik.[3]

Paditë SLAPP parashtrohen në emër të padive për shpifje, por që shihet qartë se fare nuk kanë të bëjnë me shpifje. Paditë e tilla zgjasin me vite të tëra deri në nxjerrjen e një verdikti final, prandaj janë përdorur nga individët e fuqishëm si mundësi për zgjidhjen aktuale të çështjes.

Termi "shpifje" përkufizohet mjaftë mirë në Ligjin Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes, ku thuhet:

2][<https://www.ecpmf.eu/SLAPP-the-background-of-strategic-lawsuits-against-public-participation> (1996).

[3] Për më tepër, shih: [https://eēe.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2021/694782/IPOL_STU\(2021\)694782_EN.pdf](https://eēe.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2021/694782/IPOL_STU(2021)694782_EN.pdf)

“Shpifja nënkupton publikimin e një fakti ose deklarate të pavërtetë, të cilën publikuesi e din ose është dashur ta dijë se fakti dhe deklarata është e pavërtetë, kuptimi i së cilës dëmton reputacionin e një personi tjetër”.

Ndërsa termi “fyerje” në këtë ligj përkufizohet në këtë mënyrë:

“Fyerja nënkupton deklarimin, sjelljen, publikimin e deklaratës të drejtuar ndaj një personi tjetër e cila është nënçmuese”.

Ndërsa në rastin e padive SLAPP, deklaratat e publikuara janë me interes publik, si dhe janë të bazuara në fakte dhe vërtetësia e tyre është e dëshmuar përmes informacioneve dhe provave të publikuara.

Respektivisht, në nenin 7 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes thuhet:

“Askush nuk do të jetë përgjegjës për shpifje dhe fyerje për një deklaratë të një çështjeje me interes publik, nëse ata dëshmojnë se ishte e arsyeshme në të gjitha rrethanat për një person në pozitën e tyre të përhapte materialin me qëllim të mirë, duke marrë parasysh rëndësinë e lirisë së shprehjes në lidhje me çështje të interesit publik që ai të marrë në kohë informacion për çështje të tilla”.

Për më tepër, Ligji Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes në nenin 12 të tij, parasheh edhe obligimin e personit që pretendon të jetë i dënuar me shpifje, që para ngritjen e padisë në gjykatë të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të zbutur çdo dëm që shkaktohet nga shpifja.

3.2 CILAT JANË SUBJEKTET MË TË RREZIKUARA NGA KËTO PADI DHE NGA KUSH PARASHTROHEN?

Paditë SLAPP zakonisht parashtrihen nga njerëz me pushtet, kryesisht figura publike, si: politikanë, biznesmenë të fuqishëm etj.. të cilët atakojnë gazetarët, mediat dhe aktivistët për shprehjen në publik kundër tyre, ndërmjet fakteve të paraqitura në padi që nuk kanë bazë dhe shanse për sukses, duke kërkuar qindra mijëra, e deri në miliona euro dëmshpërblime. Të gjitha këto bëhen në emër të “cenimit të imazhit dhe të reputacionit”. Pra gazetarët dhe aktivistët e mediave dhe të shoqërisë civile janë kategoritë më të rrezikuara nga këto padi. Paditësit tentojnë t'i dekurajojnë dhe t'i frikësojnë ata nga raportimi i mëtejshëm në lidhje me mbrojtjen e interesit publik, duke i detyruar ata të kalojnë nëpër procese gjyqësore të gjata dhe të kushtueshme. [4]

Me fjalë të tjera, nëse një qytetar (gazetarë, aktivist i shoqërisë civile etj.) ankohet publikisht ndaj veprimeve të ndonjë kompanie apo të ndonjë individi të famshëm e me pushtet, këta të fundit paguajnë avokatë për të ngritur padi në mënyrë që ti frikësojnë ata, e të mos vazhdojnë të shprehen publikisht në lidhje me ankesat e tyre ndaj tyre. Ndonëse paditësit e dinë mirë se paditë e tyre nuk do të kenë sukses në gjykatë, por duke e ditur se çështjet e tilla kërkojnë vite të tëra që të zgjidhen, e shfrytëzojnë këtë si rrethanë që të mbajnë të paditurit nën kërcënim të ekzistimit të një procesi gjyqësor ndaj tyre. Ndërkaq në anën tjetër, qytetarët shpesh nuk i kanë mjetet financiare për ti bërë ballë shpenzimeve të procedurës apo vihen në vështirësi ekonomike për të paguar mbrojtës që denjësisht do t'i përfaqësonte ata nëpër këto procese.

Në bazë të monitorimit nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) gjatë vitit 2021 u ngritën më shumë se 40 padi dhe u identifikuan mbi 100 padi që janë në proces në gjykatat e Kosovës ndaj gazetarëve. Nga raportimi i IKD-së, shumica e këtyre padive janë padi PSKPP që janë ngritur për t'i frikësuar aktivistët, ambientalistët dhe gazetarët.[5]

[4] Për më tepër, shih: <https://levizjafol.org/anti-SLAPP/>

[5] Shkëputur nga: KOSOVË Treguesit e nivelit të lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve 2021, fq.13

3.3 A KA MEKANIZMA LIGJOR PËR MBROJTJE NDAJ KËTYRE PADIVE?

Me 27 prill 2022, Komisioni Evropian për herë të parë ka publikuar dy instrumente të rëndësishme për të adresuar problemin e Padive Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publik (SLAPP): një draft-direktivë për mbrojtjen nga paditë SLAPP [6] dhe Rekomandimin e Këshillit kundër SLAPP. Përmes këtyre dy instrumenteve, ekzekutivi i BE-së ka propozuar masa konkrete për të mbrojtur nga paditë SLAPP gazetarët dhe aktivistët që punojnë për të ekspozuar korrupsionin dhe keq bërjet tjera.

Sipas draft-direktivës së publikuar, gazetarët dhe OJQ-të në Bashkimin Evropian do të jenë në gjendje të apelojnë në gjykata për të përjashtuar çështjet gjyqësore që janë "qartësisht të pabazuara".[7] Draft-direktiva, pra, u mundëson gjyqtarëve që të hedhin poshtë me shpejtësi paditë e pabaza kundër gazetarëve dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut. Gjithashtu, draft-direktiva përcakton disa masa mbrojtëse procedurale dhe mjete juridike, të tilla si kompensimi për dëmet dhe dënimet bindëse për ngritjen e padive abuzive.

Në konferencën për shtyp të Komisionit Evropian, të mbajtur me 28 prill 2022, ku u diskutua në lidhje me rekomandimet e propozuara, Flutura Kusari, këshilltare ligjore në Qendrën Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias, tha se propozimet e BE-së duhet të konsiderohen si një zhvillim historik. "Ne kemi parë që paditë SLAPP shkatërrojnë karrierën dhe jetën e njerëzve. Sot është bërë hapi i parë në krijimin e pengesave serioze për ata që shpresojnë të përdorin paditë SLAPP për të censuruar gazetarët dhe për të fshehur të vërtetën", ka thënë Kusari ndër të tjera në këtë konferencë. Sipas Kusarit, rekomandimet e propozuara nga ana e BE-së duhet të shihen si një standard minimal për vendet anëtare.

Më hollësisht, ndër rekomandimet e propozuara në këto instrumente, ishin:

- **Pushimi i parakohshëm i procedurave gjyqësore haptazi të pabazuara - pra, gjykatat duhet të jenë në gjendje të marrin vendime të hershme për pushimin e procedurës nëse rasti është haptazi i pabazuar. Në një situatë të tillë, barra e provës do të jetë mbi paditësin për të provuar se çështja nuk është qartazi e pabazuar;**
- **.Shpenzimet procedurale, duke përfshirë edhe tarifat e avokatit, do t'i mbulohen të paditurit nëse një çështje pushohet si abuzive;**
- **Kompensimi i dëmeve - i padituri do të ketë të drejtë të kërkojë dhe të marrë kompensim të plotë për dëmin material dhe jomaterial;**
- **Dënimet bindëse - për të parandaluar paditësin nga fillimi i procedurave gjyqësore abuzive, gjykatat do të jenë në gjendje të vendosin dënime bindëse ndaj atyre që sjellin raste të tilla në gjykatë;**
- **Mbrojtja kundër gjykimeve të vendeve të treta - Shtetet Anëtare duhet të refuzojnë njohjen e një vendimi që vjen nga një vend jo anëtar i BE-së, kundër një personi me vendbanim në një shtet anëtar, nëse procedimet do të rezultojnë haptazi të pabazuara ose abuzive sipas ligjit të Shtetit Anëtar.**

[6] Proposal of a Directive of the European Parliament and of the Council on protecting persons who engage in public participation from manifestly unfounded or abusive court proceedings ("Strategic lawsuits against public participation").

[7] [https://www.theguardian.com/media/2022/apr/27/eu-announces-plans-protect-journalists-vexatious-lawsuits-anti-SLAPP?](https://www.theguardian.com/media/2022/apr/27/eu-announces-plans-protect-journalists-vexatious-lawsuits-anti-SLAPP?fbclid=IwAR1jmEvaAxeRA45kulkmY59iu-NqIXmN1F2LJfq4Q5T1I3V6bCZJQa7i-KY)

Ndryshe, e drejta për të dhënë opinione pa ndërhyrje dhe e drejta për të shprehur në mënyrë të lirë idetë dhe opinionet e të gjitha formave, është paraparë në nenin 19 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 22 të saj, parasheh 9 marrëveshje dhe instrumente ndërkombëtare, ku përfshihet edhe kjo konventë, të cilat zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet ndaj dispozitave ligjore dhe akteve të tjera të institucioneve publike.

Gjithashtu, neni 1913 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut qartë përcakton se kush e ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe shprehjes, me ç'rast kjo e drejtë e përfshin edhe lirinë e përfaqësimit të një mendimi të caktuar si dhe lirinë për të kërkuar, për të dhënë dhe marrë informacione dhe ide përmes mediave.

Duke parë rritjen e përkushtimit të shteteve evropiane për të luftuar këtë fenomen, akterët relevant në Kosovë duhet pashmangshëm të bëhen pjesë e diskutimeve aktuale në këtë fushë, në mënyrë që të sigurohen që të mos rritet trendi i përdorimit të këtyre padive, duke e mbrojtur dhe garantuar kështu të drejtën e lirisë së shprehjes së gazetarëve dhe aktivistëve.

Për më tepër, autoritetet e Kosovës duhet të veprojnë për të siguruar që të gjithë qytetarët t'a ushtrojnë lirinë e shprehjes, qasjen në informata dhe pjesëmarrjen publike pa pasur frikë nga hakmarrja, duke përfshirë paditë SLAPP ose format tjera të keqpërdorimit të sistemit të drejtësisë.[8]

Për tu mbrojtur nga paditë SLAPP, gazetarët dhe aktivistët duhet të krijojnë një bashkëpunim të konsoliduar dhe të sigurojnë kontakte të vazhdueshme me rrjetin e organizatave që zhvillojnë programe për të mbështetur gazetarët pa kosto dhe shpenzime për çështjet që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes.

Lëvizja FOL përmes një rrjeti të organizuar të avokatëve dhe juristëve, ofron dhe koordinon mbështetje ligjore për çështje që lidhen me lirinë e shprehjes për individët dhe organizatat që punojnë në të mirën e përgjithshme. Qëllimi i këtij rrjeti të organizuar juristësh/avokatësh është që në mënyrë pro - bono të qëndrojnë në mbrojtje të fjalës së lirë dhe të ndihmojnë ligjërisht në përballjen me paditë SLAPP.

[8] Amnesty International Public Statement. Kosovë: T'u jepet fund padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike që synojnë të heshtin aktivistët e mjedisit.

4.NIVELI I PËRHAPJES SË FENOMENIT “SLAPP”

4.1 PËRHAPJA E PADIVE SLAPP NË NIVEL NDËRKOMBËTAR

Paraqitja e padive SLAPP, si padi që synojnë të frikësojnë qytetarët për mënyrën e shprehjes së tyre në publik, daton qysh në kohërat më të hershme. Rastet e padive të tilla kanë qenë të shumta, e pjesa më e madhe e tyre kanë përfunduar si të pasuksesshme nëpër gjykata.

Ligjet anti-SLAPP janë kryesisht më të zhvilluara në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanada dhe Australi, ndërsa në Evropë legjislacioni anti - SLAPP është më pak i zhvilluar. Sipas disa studiuesve, ky dallim bazohet në vlerësimet e ndryshme që sistemet kushtetuese të këtyre vendeve i bëjnë lirisë së shprehjes. Përderisa liria e fjalës mbrohet si një e drejtë pothuajse absolute nga Amendamenti i Parë i SHBA-ve, një ekuilibër i domosdoshëm midis kësaj të drejte themelore dhe interesave të tjera - siç është e drejta e reputacionit - sigurohet në sistemet e brendshme dhe rajonale evropiane (p.sh. nga neni 10 paragrafi 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut).[9]

Paditë SLAPP janë bërë temë shqetësuese vetëm kohët e fundit në Evropë, veçanërisht pas rastit të vrasjes së gazetares malteze, Daphne Caruana Galizia. Rasti i Daphne Caruana Galizia ishte ndër rastet më të spikatura të përballjes me këto lloj padish, ku me qëllim të heshtjes dhe të privimit të lirisë së saj të shprehjes, përfundoj tragjikisht.

Hulumtimi dhe raportimi i Galezias në veçanti u fokusua në gazetarinë investigative, raportimin për korrupsionin qeveritar, nepotizmin, deklaratat për pastrim parash etj.. Daphne Galizia vazhdoi të botojë artikuj për dekada me rrallë, pavarësisht frikësimeve dhe kërcënimeve të shumta, padive për shpifje dhe padive të tjera. Raportimet e saj i publikonte në blogun e saj, si dhe ishte kolumniste e rregullt e “The Sunday Times of Malta” dhe më vonë e “The Malta Independent”. Blogu i Galezias përbëhej nga raportime dhe komente investigative, disa prej të cilave u konsideruan si sulme personale ndaj individëve, duke çuar në një sërë betejash ligjore. Në vitin 2016 dhe 2017 ajo zbuloi informacione dhe akuza delikate në lidhje me një numër politikanësh maltezë, si dhe në lidhje me skandalin e Panama Papers.

Galizia u vra nga një bombë në makinën e saj në tetor të vitit 2017, pasi kishte hulumtuar në lidhje me disa anëtarë të korrumpuar të qeverisë. Sipas reporterëve, rreth 45 padi SLAPP prisnin për t’u dorëzuar kundër Galizia-s nga njerëz me pushtet në kohën kur ajo u vra në Evropë.[10]

Në konferencën për media të Komisionit Evropian të mbajtur me 27 prill 2022 , djali i Galizias, Matthew Caruana Galizia, një gazetar investigativ që ka udhëhequr një fushatë pan-evropiane kundër padive abuzive, tha se paditë SLAPP i’a kishin bërë jetën nënës së tij “një ferr të gjallë”. [11] Kjo pra më së miri dëshmon efektet që paditë e tilla mund të kenë në jetërat e njerëzve.

[9] <https://levizjafol.org/anti-slapp/#1616164865127-b7414ac7-abe0>

[10] Për më tepër, shih: <https://www.dw.com/sq/kall%C3%ABzim-p%C3%ABr-t%C3%AB-intimiduar-angazhimin-publik-padit%C3%AB-SLAPP/a-60629392>

[11] Për më tepër, shih: <https://www.theguardian.com/media/2022/apr/27/eu-announces-plans-protect-journalists-vexatious-lawsuits-anti-SLAPP?fbclid=IwAR1jmWvaAxeRA45kulkmY59iu-NqlXmN1F2LJfq4Q5TII3VëbCZJQa7i-KY>

Ky ishte rasti që i shtyu një grup deputetësh evropianë që t'i bëjnë thirrje Komisionit të Bashkimit Evropian që të promovojnë një direktivë të BE-së kundër padive SLAPP, që do t'u jepte gazetarëve dhe aktivistëve një lloj fuqie për të rrëzuar me shpejtësi këto padi. Për më tepër, euro deputetët propozuan gjithashtu krijimin e një regjistri të ri të BE-së që do të "emëronte dhe turpëronte" firmat dhe kompanitë që praktikojnë paditë SLAPP.

Në fillim të vitit 2022, gazeta investigative serbe "KRIK - Crime and Corruption Reporting Network" është përballur me 10 padi SLAPP kundër saj dhe gazetarëve të saj. Paditës në këto raste ishin persona që kishin lidhje të forta me njerëzit në pushtet. Në total, paditë kërkonin 1 milion dollarë dëmshpërblim, që është trefishi i buxhetit vjetor të kësaj organizate.[12]

Një nga këto padi, ishte ajo e kompanisë ndërkombëtare minerare "Mineco", e cila ishte shumë aktive në Ballkan. Kompania "Mineco" paditi KRIK-un dhe Kryeredaktorin e kësaj organizate, Stevan Dojčinović, për shpifje të supozuara për artikujt e saj rreth rryshfetit dhe mashtrimit të kompanisë. Kjo kompani kërkonte 500,000 dollarë dëmshpërblim ndaj gazetës "KRIK" për artikujt e publikuar.

Ky ishte ndër rastet që kishte alarmuar mediat dhe organizatat e shoqërisë civile ndërkombëtare, pasi duket se është pjesë e një përpjekjeje të përbashkët për të heshtur hetime të rënda për kriminelët dhe abuzimet në pushtetin serb.

Paditë SLAPP janë mjaft të përhapura edhe në Kroaci. Sipas Shoqatës së Gazetarëve të Kroacisë, të paktën 924 padi janë iniciuar kundër gazetarëve dhe organeve të mediave në Kroaci, në të cilat paditësit pretendojnë pothuajse 10.5 milionë euro. Midis tyre, 892 janë padi civile për shkelje të pretenduar të nderit dhe reputacionit ndaj botuesve, redaktorëve dhe gazetarëve për botimin e teksteve dhe artikujve. 32 të tjerat janë padi penale. Paditës janë individë, figura publike dhe politike, si dhe persona juridikë, politikanë në pushtet dhe gjyqtarë.[13]

Ndërkaq padia më e hershme SLAPP në historinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës ishte padia e njohur si: Harris kundër Huntington, e cila u ngrit në vitin 1802. Ky rast kishte të bënte me 5 qytetarë të Shaftsbury, të cilët i kërkuan legjislaturës së shtetit kundërshtimin e riemërimit të Harris si gjyqtar në Gjykatën e Qarkut. Ndërkaq në anën tjetër, Harris ngriti padi kundër qytetarëve për shpifje dhe kërkoi 5,000 dollarë dëmshpërblim. Pavarësisht se fillimisht gjykata shprehu disa dyshime në lidhje me vërtetësinë e deklaratave të qytetarëve, gjykata e la në fuqi të drejtën e kërkesës së qytetarëve dhe e hodhi poshtë padinë. Raste të shumta e të ngjashme të paraqitura gjatë viteve 1800 e patën fatin e njëjtë.[14]

[12] Shutting out Criticism: How SLAPPs Threaten European Democracy. The Coalition Against SLAPPs in Europe, March 2022.

[13] Për më tepër, shih: https://europeanjournalists.org/blog/2021/04/19/croatia-924-active-lawsuits-against-journalists-and-media-outlets/?fbclid=IwAR09AJ8OLSxROYuu0rgosFZKrcsSKQCODn8kP5v7LrW-9Y-17RwmME_dr_o

[14] Për më tepër, shih: <https://w.acluohio.org/en/brief-history-SLAPP-suits#:~:text=With%20the%20rise%20of%20political,SLAPP%E2%80%9D%20to%20describe%20these%20cases.>

Një rast tjetër i famshëm i padive SLAPP që kishte ndodhur në vitin 1989 në Uashington, ishte rasti ku emisioni javor i lajmeve "60 Minutes" transmetoi një lajm për efektet e dëmshme të një kimikati të quajtur "alar", i përdorur në rritjen e mollëve. Fermerët e mollëve në shtetin e Uashingtonit e paditën "60 Minutes" dhe kompanitë e saj me pretendimin se kanë shpifur në lidhje me efektet e dëmshme të këtij kimikati, duke kërkuar më shumë se 100 milionë dollarë dëmshpërblim. Padia më pas u hodh poshtë nga gjykata, të cilën më pas edhe Qarku i Nëntë i SHBA-ve e mbështeti në apel, sepse kultivuesit e mollëve nuk arritën t'i vërtetonin pretendimet e tyre se deklaratat e bëra nga "60 Minutes" ishin të rreme.

4.2 VEPRIMTARIA E KOALICIONIT KUNDËR PADIVE SLAPP NË EVROPË (COALITION AGAINST SLAPPs IN EUROPE - CASE)

CASE është një koalicion i organizatave joqeveritare nga e gjithë Evropa, të bashkuar me qëllim të identifikimit të kërcënimeve kundër punës së vrojtuesve dhe aktivistëve në mbrojtjen e interesit publik, të paraqitura ndërmjet Padive Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP). CASE punon për të ekspozuar ngacmimet dhe frikësimet ligjore, për të mbrojtur të drejtat e atyre që flasin dhe shprehin publikisht opinionet e tyre për të mbrojtur interesin publik.

CASE përmes ueb-faqes së saj po punon për të përcaktuar shtrirjen e vërtetë dhe ndikimin e plotë të padive SLAPP në Evropë - duke bashkuar të gjitha kërkimet dhe hulumtimet ekzistuese në një vend.

Në ueb-faqen e CASE mund të gjenden të dhëna të mjaftueshme në lidhje me paditë SLAPP në vendet evropiane, kampanja të ndryshme kundër padive SLAPP, mundësi për raportimin e padive SLAPP, si dhe deklaratat e viktimave të padive SLAPP për ndikimin që kanë pasur paditë e tilla abuzive në jetën e tyre.

CASE në vitin 2021 kishte organizuar edhe garën për paditë SLAPP në Evropë (European Slapp Contest 2021), e cila shënjestronte avokatin, korporatën dhe politikanin më intimidues të vitit, si dhe shtetin me më së shumti padi SLAPP gjatë vitit.

Ndërsa për vitin 2022, CASE ka nominuar edhe Kompaninë "Kelkoss Energy" për çmimin "The Corporate Bully of the Year" për paditë agresive kundër aktivistëve në Kosovë, çmim të cilin pastaj e fitoj kompania Spanjolle. Ndërsa fituesit e kësaj gare janë shpallur me 20 tetor 2022, në Konferencën e Parë Evropiane Kundër Padive Slapp, konferencë kjo e organizuar nga Flutura Kusari - Këshilltare e Lartë Ligjore në Qendrën Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias.

4.3 PËRHAPJA E PADIVE SLAPP NË NIVEL KOMBËTAR

Viteve të fundit në Kosovë është vërejtur një rritje e theksuar e nivelit të përhapjes së padive SLAPP. Këtë problem e ka theksuar edhe raportuesja për Kosovë në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon-Taubadel, e cila kishte thënë se rritja e numrit të padive për shpifje në Kosovë përbën kërcënim të konsiderueshëm ndaj debatit publik dhe lirisë së shprehjes.[15]

Rritja e numrit të Padive Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP) është përmendur për herë të parë edhe në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën, për vitin 2021.[16] Sipas raportit, gjatë periudhës raportuese është vërejtur një rritje shqetësuese e numrit të padive SLAPP para gjykatave, të cilat përdoren për të kërcënuar dhe paditur gazetarët dhe aktivistët e shoqërisë civile në mënyrë që t'i heshtin ata.[17]

Në vijim do të paraqiten disa nga rastet e padive SLAPP të paraqitura viteve të fundit ndaj gazetarëve dhe aktivistëve kosovarë.

4.3.1 KOMPANIA “KELKOSS ENERGY” KUNDËR AKTIVISTIT ADRIATIK GACAFERI

Paditë SLAPP të parashtruara nga Kompania “Kelkoss Energy” ndaj aktivistëve Adriatik Gacaferi dhe Shpresa Loshaj kishin bërë bujë të madhe asokohe dhe kishin aktivizuar organizatat e shoqërisë civile në mbrojtjen e tyre.

Fillimisht në janar të vitit 2020, Kompania “Kelkoss Energy” kishte parashtruar padi për shpifje ndaj aktivistit për mbrojtjen e mjedisit, Adriatik Gacaferit. Sipas padisë[18], Kompania Kelkoss ka kërkuar dëmshpërblim prej 10,000 Euro për dëmtim imazhi, për shkak të një postimi në rrjetin social “Facebook” në të cilin aktivisti kritikonte hidrocentralet e kompanisë në rajonin e Deçanit. “Kelkoss Energy” gjithashtu ka kërkuar që Gacaferi t'a fshijë postimin e kontestuar dhe të publikojë një deklaratë me të cilën tërhiqet nga deklaratimet e mëparshme.

Konkretisht, paditësi kishte kontestuar statusin e publikuar nga Adriatik Gacaferi në rrjetin social “Facebook” me 1 nëntor 2019, ku shkruhej:

“Hidrocentrali Lumbardhi 2 në Grykën e Deçanit sot rreth orës 14:30 duke futur 100 % të ujit në gypa edhe pse në marrëveshjen që ka me Ministrinë e Mjedisit është i obliguar që të paktën 30% të ujit ta lë gjithmonë në shtratin e lumit. Sikur të kishte pasur një gjykatë që do t'i mbronte kafshët e egra dhe peshqit, Kelkoss Energy do ishte dënua për gjenocid ndaj kafshëve dhe peshqve.”

Sipas paditësit, kjo deklaratë është e pavërtetë dhe se deklaratat e tilla që cenojnë integritetin dhe reputacionin e individëve, duhet të sanksionohen me anë të dispozitave ligjore.

Ashtu siç do të shpjegohet edhe në vazhdim, pas reagimeve të aktivistëve dhe organizatave të shoqërisë civile, kompania “Kelkoss Energy” kishte hequr dorë nga kjo padi.

[15] Për më tepër, shih: <https://violavoncramon.eu/en/nees/content/increasing-SLAPP-lawsuits-in-kosovo/>

[16] European Commission, Kosovo 2021 Report, page 31.

[17] Po aty.

[18] Padija për kompensim dëmi për shkak të shpifjes, e parashtruar nga Kelkoss Energy Sh.P.K. ndaj Adriatik Gacaferi, me 31 janar 2020.

4.3.2 KOMPANIA “KELKOSS ENERGY” KUNDËR AKTIVISTES SHPRESA LOSHAJ

Në vitin 2020 kompania “Kelkoss Energy” kishte parashtruar padi edhe ndaj aktivistes së mbrojtjes së mjedisit dhe themelueses së organizatës joqeveritare “Pishtarët”, Shpresa Loshaj. Në këtë padi, “Kelkoss Energy” kërkoi dëmshpërblim prej 100,000 euro nga Loshaj për dëmin e shkaktuar me fushatën e saj publike kundër veprimtarisë së “Kelkoss Energy” në rajonin e Deçanit, ku kompania menaxhon katër hidrocentrale.

Sipas asaj që është paraqitur në padi, që nga maji i vitit 2020, Shpresa Loshaj është shprehur publikisht duke kontestuar ligjshmërinë e veprimit të hidrocentraleve të Kelkoss Energy, si dhe duke deklaruar se kjo kompani është duke kontribuar në shkatërrimin e mjedisit dhe natyrës, të gjitha këto duke pretenduar se licenca e poseduar nga kjo kompani për prodhimin e energjisë është në kundërshtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energji Elektrike, si dhe Ligjin për Licencim të Aktiviteteve të Energjisë. “Kelkoss Energy” ka kërkuar në padi që Loshaj t’a tërheqë deklaratën e saj publike, të kërkojë falje publikisht dhe në të ardhmen të shmangë deklaratat rreth kompanisë me “fakte të pavërteta”.^[19]

Koalicioni Ad - Hoc i organizatave të shoqërisë civile^[20] kishin shprehur reagimin e tyre dhe kishin kërkuar nga kompania “Kelkoss Energy” që pa vonesë ta tërheqë padinë SLAPP kundër Gacaferit dhe Loshajt.^[21]

Si përfundim, me 18 tetor 2021 Kompania “Kelkoss Energy” kishte dërguar një shkresë në gjykatë, në të cilën ka njoftuar se ka hequr dorë nga paditë ndaj aktivistëve të mjedisit, Gacaferit dhe Loshajt.

[19] Për më tepër, shih: <https://www.amnesty.org/en/wp-content/uploads/2021/07/EUR7343502021ALBANIAN.pdf>

[20] Ky koalicion përbëhet nga: Lëvizja FOL, Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF), Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Debate Center, D4D, KFOS, OJQ Era, Flutura Kusari, Ardian Nrecaj, Çohu!, Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), Demokraci Plus, Nisma për të Drejtat e Njeriut - Kosovë (YIHR), Grupi për Mbrojtjen e Ujërave dhe Mjedisit, Kosovo Mountain Club, Instituti i Kosovës për Drejtësi, Instituti GAP, BIRN Kosova, Interneës Kosova, Pishtarët, Instituti EPIK, Syri i Vizionit, CEL Kosova, KEN Netëork, Integra, Sbunker, Organizata EcoZ, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, Shoqata e Intelektualeve të Pavarur në Deçan, Albert Heta, Qendra Kosovare për Studime Gjinore, OJQ TOKA, GAIA Kosovo, INJECT, Rrjeti i Grave të Kosovës, Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore - CSGD, Community Building Mitrovica, ADMOVERE, KMDLNj, Let's Do It Peja, Ec ma Ndryshe, POLIS, 'Ecopana', Let's do it Kosova.

[21] Për më tepër shih: <https://levizjafol.org/wp-content/uploads/2021/02/Lete%CC%88r-mbe%CC%88shtete%CC%88se-pe%CC%88r-aktivisten-Shpresa-Loshaj.pdf>

4.3.3 RADIO TELEVISIONI I KOSOVËS (RTK) KUNDËR AKTIVISTIT AGRON DEMI

Në fund të vitit 2021, përkatësisht në tetor të këtij viti, Radio Televizioni i Kosovës (RTK) kishte parashtruar padi për shpifje ndaj aktivistit dhe analistit të politikave në Institutin GAP, Agron Demi.

Televizioni publik e kishte paditur Demin, duke pretenduar që kritikën e Demit përmes statuseve në rrjetin social "Facebook", të shoqëruara me kërkesë për mbyllje të transmetuesit publik, përbëjnë gjuhë të urrejtjes dhe fyerje ndaj televizionit dhe punonjësve të tij.

Përkatësisht, objekt i kësaj padie ishte postimi i Demit në rrjetin e tij social "Facebook", i bërë me datë 13 mars 2020, ku ndër të tjera kishte shkruar:

"E kisha shtu edhe një masë për ruajtjen e shëndetit: mbylljen e menjëhershme të RTK-së.." Sipas padisë, me deklaratat e lartcekura i padituri ka krijuar një kampanjë kundër Radio Televizionit të Kosovës duke shpifur dhe fyer atë, me ç'rast ka kërkuar që i padituri të kërkojë falje publikisht dhe të tërheqë deklaratat shpifëse dhe fyese ndaj RTK-së, si dhe i njëjti të pretoj se deklaratat e tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

Koalicioni Ad - Hoc i organizatave të shoqërisë civile kishin reaguar edhe në këtë rast dhe kishin kërkuar që Radio Televizioni i Kosovës menjëherë ta tërheqë padinë dhe në të ardhmen të përmbahet nga veprimet që rrezikojnë lirinë e shprehjes së aktivistëve dhe dekurajojnë monitorimin e këtij institucioni.[22]

Ndërkaq me 26 janar 2022, Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) ka dërguar një shkresë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me ç'rast ka njoftuar se e ka tërhequr padinë ndaj Agron Demit.

4.3.4 ASDREN GJIKOLLI (GJIKO) KUNDËR GAZETARËVE TË MEDIAS ONLINE "FRONT ONLINE"

Më 31 mars 2022 këngëtarin Asdren Gjiko, i njohur ndryshe me nofkën artistike Gjiko, ka parashtruar padi për shpifje kundër Lavdim Hamidit (gazetarë në "Front Online"), ku ka kërkuar largimin e statusit në rrjetin e tij social "Facebook", status ky që përshkruante dhe informonte publikun në lidhje me akuzat e Prokurorisë Themelore në Prishtinë që e ngarkonin paditësin për dhunimin e një të miture. Paditësi përmes padisë kishte kërkuar edhe dëmshpërblim në vlerë prej 5,100 euro.

Statusi i gazetarit Hamidi në rrjetin e tij social "Facebook", që është atakuar me padi, ishte: "Aktakuza ndaj këngëtarit Gjiko është e tmerrshme. Çka shkruan aty e mos me shku asnjë ditë në burg vetëm në Kosovë ndodhë. Janë gjashtë vepra penale në një dokument disa faqësh. Edhe më keq shkon i paguan avokatët me u bo padi mediave. Unë nuk po mundëm me lexu se çka shkruan aty, se çka kanë bërë me një vajzë të mitur! Megjithatë faktet do të prezantohen në gjykatë."

[22] Për më tepër, shih: <https://levizjafol.org/rtk-te-terheqe-padine-SLAPP-kunder-aktivistit-agron-demi/>

Statusi, siç përmendet edhe në të, ishte bazuar në aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të ngritur me 3 prill 2017. Pra, sipas padisë, i padituri është përgjegjës për publikimin e një shkrimi të tillë shpifës dhe se veprimi i tillë është në lidhje kauzale me dëmtimin e reputacionit të paditësit. Paditësi po ashtu ka kërkuar nga gazetari Enis Veliu (Drejtor Ekzekutiv i “Front Online”) largimin e statusit nga rrjeti social “Facebook” lidhur me procesin gjyqësor që po zhvillohet ndaj tij.


Me 20 prill 2022, Koalicioni Ad – Hoc i organizatave të shoqërisë civile kishin reaguar edhe në lidhje me këtë rast dhe kishin kërkuar nga Asdren Gjikolli që menjëherë ta tërheqë padinë dhe të zbrapsset nga përpjekjet për t'i frikësuar gazetarët dhe për ta penguar raportimin për akuzat ndaj tij.[23]

Sipas deklaramit të Koalicionit Ad-Hoc, padia e Asdren Gjikollit e shoqëruar me kërkesat për masa të përkohshme është Padi Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike (padi SLAPP) dhe si e tillë nuk ka gjasa që të ketë sukses në gjykatë. Kjo padi ka për qëllim që të pengojë raportimin e akuzave për dhunim që rëndojnë mbi Gjikollin duke i zvarritur gazetarët nëpër gjykata dhe duke ju shkaktuar kosto financiare dhe shqetësim. Përpos kësaj, me padi synohet të dekurajohen edhe gazetarët tjerë nga raportimi lidhur me procesin gjyqësor që po zhvillohet ndaj Gjikollit.[24]

5. SA JANË TË NJOFTUAR GAZETARËT DHE AKTIVISTËT KOSOVARË ME PADITË SLAPP ?

Lëvizja FOL ka anketuar mbi 30 gazetarë dhe aktivistë kosovarë në lidhje me atë se sa janë të informuar për këto lloj padish në përgjithësi, prej ku janë nxjerrë të dhënat e paraqitura në tabelat e mëposhtme. Së pari, FOL ka kërkuar të dijë se sa janë të informuar gazetarët dhe aktivistët kosovarë me termin “padi SLAPP”. Së dyti, se a kanë qenë ndonjëherë të kërcënuar nga ngritja e këtyre padive apo a kanë pasur ndonjë rast të përballen me to nëpër gjykata. Dhe së fundi, FOL ka kërkuar të dijë se sa janë të informuar për mekanizmat ligjor për mbrojtjen nga paditë SLAPP.

Është me rëndësi të theksohet se nga të gjitha përgjigjet, në përgjithësi gazetarët dhe aktivistët janë të informuar me termin “SLAPP”. Nga të gjithë të anketuarit, vetëm 12 prej tyre janë përgjigjur se nuk kanë dëgjuar ndonjëherë për paditë SLAPP.




Grafiku 1. Përgjigjet e gazetarëve dhe aktivistëve në lidhje me atë se sa janë të informuar me Paditë SLAPP.

[23] Për më tepër, shih: <https://levizjafol.org/asdren-gjikolli-gjiko-te-terheqe-padine-slapp-kunder-gazetareve-te-frontonline/>


[24] Po aty.

Sa i përket pyetjes se a kanë qenë ndonjëherë të kërcënuar nga ngritja e këtyre padive, apo se a kanë pasur rast të përballen me to në gjykata, 3 prej të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa të tjerët, apo 26 prej tyre, janë deklaruar se nuk kanë pasur raste të tilla.



Grafiku 1. Përgjigjet e gazetarëve dhe aktivistëve në lidhje me atë se sa janë të informuar me Paditë SLAPP.

Ndërkaq sa i përket informimit të tyre për mekanizmat ligjor për mbrojtjen nga paditë SLAPP, gazetarët dhe aktivistët janë shprehur se janë fare pak të informuar. Vetëm 3 të anketuar janë shprehur se kanë njohuri për mbrojtjen ndaj tyre, ndërsa 26 të tjerë janë përgjigjur se nuk kanë njohuri të tilla.



Grafiku 3. Përgjigjet e gazetarëve dhe aktivistëve se sa janë të informuar për mekanizmat ligjor për mbrojtjen ndaj padive SLAPP.

REKOMANDIME

Nga të dhënat e paraqitura në këtë raport dhe nga niveli i përhapjes së këtij fenomeni në shoqërinë tonë, Lëvizja FOL jep këto rekomandime:

- Të tregohet përmbajtje maksimale në parashtrimin e padive ndaj gazetarëve dhe aktivistëve dhe këto padi të përdoren vetëm si mjete të fundit, duke u siguruar që çdo ndërhyrje e mundshme të jetë proporcionale me qëllimin legjitim që kërkohet të arrihet dhe të mbrohet interesi publik.
- Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprime konkrete në ndërtimin e infrastrukturës ligjore për parandalimin e padive SLAPP, duke u bazuar në Draft-Direktivën e Parlamentit dhe Këshillit Evropian për mbrojtjen e personave të përfshirë në aktivitete publike nga proceset gjyqësore qartazi të pabazuara ose abuzive (Paditë Strategjike kundër pjesëmarrjes së publikut).
- Të kërkohet bashkëpunimi i Odës së Avokatëve si dhe shoqërive të avokatëve me qëllim të ofrimit të ndihmës juridike pro-bono për gazetarët, aktivistët apo persona të tjerë që do të jenë cak i padive SLAPP.
- Rastet e vërtetuara të padive SLAPP të jenë objekt i denoncimit publik para mediave dhe grupeve të interesuara.
- Të ofrohen trajnime për profesionistë të fushës për njohjen dhe trajtimin e këtyre padive abuzive.
- Të organizohen fushata vetëdijësuese publike për rëndësinë e lirisë së shprehjes dhe rastet në të cilat ajo kufizohet.
- Gjykatat para vlerësimit të bazueshmërisë së padive për shpifje të vlerësojnë nëse është përmbushur kushti i paraparë në nenin 12 të Ligjit Civil Kundër Shpifjes dhe Fyerjes në lidhje me detyrimin për zbutje të dëmit të shkaktuar dhe parashtrimin e kërkesave për përgënjeshtrim të shpifjes. Paditë të cilat nuk e kanë mbushur këtë kriter të hedhen poshtë nga gjykatat.

